



Iniciativa të Institutit Urban për decentralizimin në Shqipëri

Konteksti i projektit

Vendosja e një sistemi demokratik të qëndrueshëm në Shqipëri kërkon një qeverisje me eficientë dhe të përgjegjshme, kërkon përfshirje të gjerë qytetare në proceset e vendimmarrjes dhe në zbatimin e programeve të përbashketa të zhvillimit. Shume nga drejtuesit e qeverise vendore në Shqipëri e vleresojnë kontributin e pjesëmarrjes qytetare. Shume nga këta drejtues përipiqen me sa mundën për të përfshirë qytetarët. Në këto përpjekje, shumë nga zyrtarët e gjejnë veten me mangësi për sa i përket mjeteve që stimulojnë pjesëmarrjen e vazhdueshme të qytetarëve. Filozofia e re dhe mënyrat e administrates publike synojnë jo vetem fuqizimin e qytetareve por edhe pjesëmarrjen aktive me metoda dhe mjete të ndryshme. IKU u perfshi në hartimin dhe organizimin e disa trajnimeve për të zbatuar këto mjete dhe teknika për pjesëmarrjen, nëpërmjet disa komponentëve.

Komponentët e projektit

Komponenti 1: Përgatitja dhe organizimi i trajnimeve mbi "Matjen e informacionit të grumbulluar nga qytetarët dhe cilësisë së shërbimeve". Aktivitetet përfshijnë përgatitjen e materialeve të trajnimeve në bashkëpunim me Institutin Urban dhe organizimin e 8 trajnimeve kyçe në bashki të ndryshme mbi Marrjen e Opinionit Qytetar për Cilesinë e Shërbimeve. Duke përfshire më shumë se 40 bashki dhe komuna të Shqipërisë. Gjithashtu përfshihet edhe përgatitja dhe organizimi i një kursi trajnimi për vullnetarët e Korpusit të Paqes të ShBA (link with the PCV) në Shqipëri.

Komponenti 2: Dhënia e trajnimeve bazë mbi llogaritjen e kostove dhe caktimin e tarifave për shërbimet publike - shtatë kurse trajnimi do të organizohen në njësi të ndryshme të qeverise vendore, duke përfshirë rreth 40 njësi të qeverisjes vendore në Shqipëri.

Komponenti 3: Programi i zbatimit të buxhetit-Dhënia e ndihmës 10 qyteteve pilot për të implementuar matjen e performancës në procesin e planifikimit për përmirësimin e shërbimeve, duke i kushtuar rëndësi sidomos: ngritjes së grupeve të punes në çdo qytet; sigurimit të ndihmës që do t'u jepet qytetarëve

Rreth IKU

Që nga viti 1999 Instituti i Kërkimeve Urbane (IKU) ka dhënë rezultate të mëdha për projektet dhe programet e zhvillimit të realizuara në të gjithë Shqipërinë. Puna jonë në kryesore përqendrohet në zhvillimin e komunitetit, forcimin e qeverisjes vendore, mbrojtjen e mjedisit, decentralizimin dhe shërbimet publike. Ne kryejmë studime, llojmë qeverinë, trajnojmë njësitë e qeverisjes vendore, rrisim aksesin e publikut në informacion, dhe lidhim partnerët në punën për zhvillim.. IKU ka punuar me donatorë si USAID, Bashkëpunimi Zviceran, Ambasada Holandeze, UNDP, Banka Botërore, BE, SIDA, Shoqëri të Hapur / Fondacioni Soros, etj.



për të zhvilluar plane veprimi për përmirësimin e shërbimeve, duke aplikuar teknikat e pjesëmarrjes qytetare në procesin e buxhetimit për vitin 2005; organizimit dhe supervizimit të studimit të implementuar në gjashtë qytete me qëllim përcaktimin se si e shikojnë qytetarët e lokaliteteve realizimin e shërbimeve nga pushteti lokal; pjesëmarrjes dhe bashkëpunimit me organizata të ndryshme në takime të ngjashme.

Komponenti 4: Mbështetja e Programit për decentralizimin e sistemit të ujësjellësit –asisitimi në analizimin e të dhënave të kompanisë së Ujesjellsit në Librazhd, për të kontribuar në decentralizimin e shërbimit të ujësjellsit dhe pronesisë së qeverisë vendore. Aktiviteti është hartuar për t'i siguruar një asistencë teknike projektit pilot mbi ujësjellësin, duke përfshirë: identifikimin dhe analizimin e opsioneve të ndryshme që ekzistojnë për të ndarë dhe për të shpërndarë sipas preferencave të njësisve të qeverisjeve vendore pronën e Sistemit të Ujësjetësit, në mënyrë që transferimi i pronës të arrihet me mirekuptim; analizimin e burimeve kryesore financiare dhe nderlikimeve të ndryshme që ekzistojnë në buxhet për transferimin e mundshëm të pronës së bashkisë që është e lidhur me këtë sistem pilot; identifikimin e hapave për të garantuar pushtetin lokal për një veprimtari të vazhdueshme dhe mirembajtjen e sistemit të ujësjellësit dhe zhvillimin e planeve për implementimin e këtyre fazave. Asistim dhe pjesëmarrje në takime të ndryshme që lidhen me këtë aktivitet.

Komponenti 5: Implementimi i menaxhimit të performancës – Mbështet dhe ndihmon konsulentët e huaj nga SH.B.A në workshop dhe aktivitete të ngjashme për të prezantuar

menaxhimin e performancës; hartimi dhe drejtimi i planeve në vazhdimësi për implementimin e menaxhimit të performancës ashtu si është e zbatuar në buxhetin e pushtetit lokal në Shqipëri. Ky aktivitet përmban përgatitjen, organizimin dhe zbatimin e një sërë studimesh në kater njësi të pushtetit lokal: Elbasan, Prrenjas, Pogradec e Kuçove duke përfshirë edhe hedhjen në tabela, raportin dhe prezantimin e rezultateve të studimit, si dhe paraqitjen e këtij studimi në pushtetin lokal për të përgatitur buxhetin për vitin 2004. Ofrimi me i mire i shërbimeve, sigurimi që qytetarët janë informuar mbi ndryshimet e politikave, ofrimi i një qendre ku të kërkohet informacion nga qytetarët apo të behen ankesat, atehere kur nevojitet, është një sfidë e madhe e cila është arritur nga këto bashki.

FAKTET KRYESORE

PARTNERET:

- ✓ USAID/The Urban Institute (Washington D.C.)

KOHËZGJATIA:

Nentor 2003 – Gusht 2004

PËRFITUESIT:

- ✓ Bashkia e Pogradecit
- ✓ Bashkia e Kuçoves
- ✓ Bashkia e Prrenjasit
- ✓ Bashkia e Elbasanit

KONTAKT:

Zana Vokopola
Drejtoresh Ekzekutive

Instituti i Kërkimeve Urbane

Rr. Asim Vokshi, Nd.14
Hyrja 11, Ap. 56
Tiranë
Tel: +355 4 2256840
E-mail: uri@uri.org.al
Web: www.uri.org.al